

Mehmet Halimi

NAZALIZMI NË TË FOLMEN E MORAVËS SË EPËRME

Nazalizmi është i pranishëm në këtë të folme në një shkallë të mesme, duke mos arritur intensitetin e zanoreve hundore të të folmeve të tjera të Gegërisë veriperëndimore.¹ Pra, ndër tipare të tjera të kësaj së folmeje është edhe nazalizmi.

Siç dihet, nazalizmin e shkaktojnë prania e bashkëtingëlloreve hundore *m*, *n*, *nj*, kur këto gjenden prapa zanoreve përkatëse. Mirëpo pos këtyre rasteve nazalizmi në këtë të folme paraqitet edhe atëherë kur mungojnë bashkëtingëlloret hundore, duke mos lënë asndonjë gjurmë në evolucionin e tyre përkatës, por zanoret e nazalizuara në këtë mënyrë i nënshtrohen analogjisë së nazalizimit të zanoreve në fjalë të tjera.

Zanoret nazale dhe nazalizmi si dukuri fonetike, që është veçori edhe e kësaj së folmeje, ashtu siç është veçori e mbarë të folmeve gege, mund të shqyrtohet në tri aspekte:

1. *Zanoret nazale primare*
2. *Zanoret nazale sekondare* (sipas analogjisë) dhe
3. *Zanoret e denazalizuara* (nga dobësimi i intensitetit ato janë denazalizuar, ndërsa në disa raste kemi edhe rotacizimin e disa fjalëve).

1. Sa u përket **zanoreve nazale primare** kemi të bëjmë me parimin e bashkëtingëlloreve hundore *m*, *n*, *nj* ose gjurmët e hershme të tyre, të cilat duke u zhdukur krejtësisht kanë lënë jehonën e tyre prapa, kanë lënë gjurmët e veta, duke nazalizuar zanoret që dikur gjendeshin përballë këtyre bashkëtingëlloreve hundore.

Nazalizohen të gjitha zanoret, pos *ë*-së. Më rrallë e ndeshim të nazalizuara zanorën *o*. Ndërsa nazalizimi i zanoreve të tjera është shumë i shpeshtë.

Po sjellim shembuj të nazalizimit me praninë e drejtpërdrejtë të *m*-së, *n*-së dhe *nj*-së:

â-ja nazale: *zâ-ni*, *mullâ-ni*, *fshâ-ni*, *me prâ-prâni*, por edhe *prâjti*, etj.

¹ E. Ç a b e j, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1970, 114: „Sot nazalizmi është një fenomen i gegërishtes, po duhet ditur se jo gjithë Gegëria e ka njëlloj. Ka ndryshime intensiteti sipas krahinave, p.sh. Gegëria veriore e ka më të fortë se ana lindore“.

Te shqiptimi i \hat{a} -së nazale ndeshim nuanca të vogla labializimi drejt *o*-së: \hat{a}^o , $\hat{z}\hat{a}^o$ ni, $\hat{b}\hat{a}^o$ ni, \hat{a}^o sht, etj.

\hat{e} -ja nazale: $\hat{f}\hat{r}\hat{e}$ -ni, $\hat{p}\hat{e}$ -ni, *me rrêjt /rrena/, pês*, etj. Në disa fshatra të Preshevës e të Bujanovcit dhe në fshatrat e Karadakut të Gjilanit *e*-në e gjejmë të denazalizur, p.sh.: $\hat{p}\hat{e}s/e$ orale fshati Shushajë,² etj.

\hat{i} -ja nazale: $\hat{t}\hat{p}\hat{i}$ ni, $\hat{f}\hat{i}$ -ni /por edhe $\hat{f}\hat{i}$ -ja/, $\hat{t}\hat{h}\hat{i}$ -ni, $\hat{l}\hat{i}$ -ni, $\hat{h}\hat{i}$ -ni, $\hat{m}\hat{u}\hat{l}\hat{l}\hat{i}$ -ni,³ *m'u zgërdhî /zgërdhîni/, m'u mërdhî /u mërdhîna/, m'u shtrî /e shtrîni, u shtrîna/.*

Në Gollak, Llap, Drenicë e në një pjesë të Rrafshit të Dukagjinit ndeshim kalimin e \hat{i} -së në \hat{e} , p.sh.: *m'u shtrê, u shtrêna, u shtrêne, u shtrê.* /Khs. *shperti* në „Formulën e pagëzimit” për *shpirti*, ku kemi diftongimin e *i*-së në *e*, fenomen i cili sipas B. Becit⁴ ishte i gjallë në fillim të shek. XV.

\hat{u} -ja nazale p.sh. $\hat{d}\hat{r}\hat{u}$ -ni, $\hat{t}\hat{r}\hat{u}$ -ni, $\hat{h}\hat{u}$ -ni, $\hat{g}\hat{u}$ -ni, *me prû /aoristi prûna/, shllûn, me shkûn, me lkûn /likun(d), grûn-i/ Livadhet e Grûjes*, toponim në fshatin Komogllavë, dikur këto livadhe ishin ara të mbjella me grurë, tani janë livadhe, ndaj quhen kështu. Khs. te Gazulli *drûjç-e* prej drunit, *Fjalorthi i ri* fq. 115.

\hat{y} -ja nazale — shqiptohet duke e hapur gojën pak e duke zgjatur buzët në formë të rrumbullakësuar, e duke kaluar një pjesë e zërit nëpër gavat e hundës, artikullohet një \hat{y} plotësisht e nazalizuar, p.sh.: $\hat{s}\hat{y}$ -ni / $\hat{s}\hat{o}$ ni apo $\hat{s}\hat{e}\hat{i}$ ni/,⁵ $\hat{d}\hat{r}\hat{y}$ -ni, *me frÿ-frÿni*, etj. Në disa fshatra të Karadakut të Gjilanit /Dunav/ dëgjojmë: $\hat{f}\hat{r}\hat{o}$ ni, $\hat{d}\hat{r}\hat{o}$ ni, $\hat{a}\hat{t}\hat{o}$ ne, $\hat{k}\hat{t}\hat{o}$ ne, etj.

\hat{o} -ja nazale. — Rrënja e gjuhës tërhiqet pas, sidomos në pjesën e sipërme. Ashtu si me rastin e shqiptimit të zanoreve të tjera nazale edhe në këtë rast një pjesë e zërit kalon nëpër gavat e hundës, duke na dhënë një *o* të ngjyrosur me një nuancë hundësimi, por me një intensitet shumë më të vogël se sa zanoret e tjera nazale, p.sh. $\hat{f}\hat{t}\hat{o}$ ni, $\hat{t}\hat{h}\hat{o}$ ni, $\hat{k}\hat{r}\hat{o}$ ni, etj., që këtu *o*-ja është e nazalizuar në një nuancë shumë të vogël nga ndikimi i pranisë së drejtpërdrejtë të konsonantit *n*, ndërsa kur mungon *n*-ja zhduket edhe nazaliteti: *ftue-ftôj*, por më rrallë edhe $\hat{f}\hat{t}\hat{o}$ j në disa fshatra, *thue-thoj-t krue-krû-krôj-t*, etj. Kurse te zanoret të tjera përkundrazi, me zhdukjen e *n*-së apo *nj*-së intensiteti nazal është edhe më i madh. Sa i përket \hat{o} -së nazale, pothuaj pak ka elemente që të trajtohet si zanore nazale, pos në shembujt që përmendëm, dhe në foljet: *kôm, jôm, thôm*, te të cilat kemi rastin e labializimit të *a*-së në *o* /jam, kam, me thanë/ si dhe te një numër i konsiderueshëm fjalësh, ku kemi të bëjmë me një \hat{o} nazale, që nuk është një *o* e kryehershme, por një labializim i plotë i *a*-së në *o*, p.sh.: *e kôjtja e korÿ*

² I. A j e t i, Rreth disa tipareve të të folmeve të shqiptarëve të rrethit të Preshevës dhe të Bujanovcit, Gjurm. alban. nr. 2, 1969-41.

³ E. Ç a b e j, në veprën *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe*, fq. 152, lidhur me nazalitetin pohon: „Në një periudë të përbashkët paragege të shqipes, mungonin kushtet fonetike për nazalizimin e *i*-së, kurse sot në gegërishten, në fjalë të tilla si *li, mulli*, kjo është një dukuri e rëndomtë, këtë ndryshim e spiegoj kështu, që në shkallë të moçme të shqipes zanoret nazale shqiptoheshin me një ulje të fortë të pëlurës së palatit e me qëndrim të ulët të gjuhës afërsisht ashtu si sot në frengjishtë”.

⁴ B. B e c i, *Mbi katër inovacione fonetike të të folmeve të Gegnisë së mesme*, Konf. I e stud. alban. 15-21 nëntor, 1962, Tiranë, 1965, 265/khs. *Balldrë-ni* e vitit 1671, *Merediti* e vitit 1500, etj/.

⁵ M. H A L I M I, *Skicë mbi të folmen e fshatrave Mjak dhe Fanishec*, Gjurm. alban. ser. fil. nr. III, 1973, Prishtinë 1975, 66.

burrin nga /*kandje*/, *lông-i*, *krône* /*krônde*/ : *burri me lông e kavi me krôn* nuk *bâ°n* hiç, *njôni* /*njâni*/, *dërpôjt/i* muren *dërpôjt*, por edhe *drapnojt*, *vrôm-i*.⁶ *kish bâ° breshni kallamoçin vrôm!*, *shkôm-i* „*shkëmb-i*” /*dôm-i*/ *dam-i*/, *akshôm*/ turq. *aksham-i*, *pllôm-a*. Këtu duhet veçuar pjesën jugperëndimore të kësaj treve, fshatrat: *Vërban*, *Kabash*, *Smirë*, *Sodovinë*, te të cilat *a*-në qoftë nazale, qoftë orale nuk e përshkon kurrëfarë labializimi, por thuhet: *jam*, *kam*, *tham*, *pllam*, *dam*, *aksham* etj.

Shembujt që sollëm më lart lidhen me nazalizimin e zanoreve që kishin të bëjnë me praninë e drejtpërdrejtë të bashkëtingëlloreve hundore *m*, *n*, *nj*. Mirëpo, përveç këtyre rasteve që vumë në spikamë, ndeshemi në zanore të nazalizuara edhe atëherë kur mungon prania e konsonanteve të përmendura, qoftë në trajtën e pashquar, qoftë në trajtën e shquar, nëse kemi të bëjmë me emra, apo si në infinitiv ashtu edhe në aorist, nëse kemi të bëjmë me folje. Kjo ndodh që në një të kaluar të afërt apo shumë të largët, në kryeherën e etimologjisë së fjalës zanorja e saj e sotme nazale ka qenë e ballafaquar me njërin nga konsonantet *m*, *n*, *nj*, të cilat edhe pse janë zhdukur kanë lënë gjurmët e tyre. P. sh. në Moravën e Epërme shqiptohet me *ê* nazale fjala *skêj-i*, që sipas E. Çabejt ka evoluar nga *skanj*, *skêj*.⁷ Në fshatin Gramoçel të Rekës së Mirë /Rrafshi i Dukagjinit/ kemi ndeshur në fjalën *skêjçe*,⁸ po kështu te fjala *sêj-i*, për *saj-i*, mos kemi të bëjmë me një *sanj* analog me *skanj*?

Me *ê* nazale shqiptohet edhe numri *pês* /Pjetër Bogdani pensë,⁸ *fshîs-a*, që ka prejardhje nga folja me *fshî*, /*fshini*, *fllâz-a*/ nga *thëllanzë-a*/, *kthîz-a*, nga *kërthinzë-kërthizë-kthîz*; *karthîc-i* /nga *karthina*/, khs. *kathic-i*, pjesa anatomike e trupit, lat. *clitoris-dis*, (D. Nikollë Gazulli, Fjalorth i ri, rib. Rilindja 1968, 195); *pâj-a*, *m'u dêj* /nga *denjë*/, në Tanishec, fshat në majë të Kopilaçës, thuhet *m'u vdê bora*, e *êjte /e enjte/*, *shkllî-ja* nga *shkllinjë-a*; *shêj-i*, nga *shenjë-a*, *shenj-i*: me *shêjû*, *shêjtâr*; me *flêjt* /nga *flânë*, *flenë*/; me *mêjt* nga *mêni*, por *mênt*, *dhênt*, *çênt*, e jo *mêt*, *dhêt*, *çêt* sikurse përdoret në të folme të tjera të gegërishtes verilindore: të Shalës së Bajgorës, të Llapit, të Drenicës, dhe në të folmen e Karadakut të Gjilanit, që është fqinje me këtë të folme. Mirëpo përkundër trajtave: *mênt*, *dhênt*, *çênt*, në këtë të folme ndeshim *i mêçum*: nga *i mentshëm-i mençëm* — *i mêçum*, *gjÿs-a* /nga *gjysma*/ në këtë fjalë kemi një hundësim me një intensitet shumë të dobët, ku në këtë rast *y*-ja gati është e denazalizuuar; *ûthi* /nga *unth-i* që e gjejmë në Llap e Gollak; *thÿja* /nga *thinjë-a*, *i thinjur*/; *skûth-i* nga një trajtë* *skunth-i* /*û*, *ûja* nga *i untë*, *smûj-a*/ nga *i smund*/, *xhâ-ja*/ nga *xhanë* me kuptim *kafshë*/, *gërdhâj-a*/nga *gërdhâ-ni*/, *pastorkî*/

⁶ Fjala që përdoret në Moravën e Epërme mendoj se ka prejardhje nga greqishtja *dhrom-i*, me kuptim *rrugë*, *xhade*, ku *dh* ka kaluar në *v*, duke na dhënë formën *vrom-i*. Këtu konkretisht e ka rrahë breshëri misrin, e ka shtruar, duke e dëmtuar krejtësisht, ku nuk duket se ka pasur ndonjë kulturë bimore, por është bërë rrugë e vërtetë, është shkretëruar, khs. *dhrom-i* /*vrom*/ rruga e përgjithshme, fr. *chemin battu*, *grand chemin*, *grad/rout* /Chaukat S. Gavoci, *The parbs dictionary in albania French and english languages*, Damask 1970, 34.

⁷ E. Ç a b e j, *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe*, fq. 80.

⁸ E. Ç a b e j, *shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe*, fq. 154 përmend edhe fjalën *vês-it* përballë *visë*; *pêsë* /*Bogdani pensë*/, që dëshmojnë se në një periudhë të përbashkët paragege të shqipes mungonin kushtet fonetike për nazalizimin e *î-së*/ te Gazulli ndeshim *skâjulluer-ori*, vegël zdruktharësh, Fj, Ri, fq. 370.

nga *pastorkinja* në serbishten, për thjeshtër në gjininë femërore/; *grêjzi*, por dëgjohet edhe trajta e denazalizuar *grejzi*; *me cîjât /cinjât/* Gazulli, *qeni kthîs* mas lepurit, 371/; *tesha të lîjta/*, *çarapa të dhîjta*, *thas të dhîjt/* nga *të linta*, *të dhinta* — nga leshi i dhisë/, *i shpërdhîjt/ i shpërdhînt/*, *khâ-eja khâ/* te Gazulli kemi *kehân/*, *kllî-ja* nga *kllî-ni*, që dikur ishte në gjininë mashkullore, *me kî rrushin /nga me kinu/*, *i shtrêjt/* nga *i shtrenjt/*, *Viti-ja /nga Vitinë-a/*. Po kështu disa fjalë me origjinë sllave që kanë një *nj* prapa një zanoreje, në të folmen e Moravës së Epërme kanë përfunduar në zanore të nazalizuar me një intensitet mjaft të lartë, si për shembull: *Vrâj-a /nga serbishtja Vranje/*, *Ramabâj-a /nga sllavishtja Ravna-banja/*, *Zhit-ja /emër fshati Zitinje/*, *tî-ja /rërë e imtë/* nga *tinjak*. Ndërsa *lopa mâz*, *stërmâz /ndoshta nga* manzë-a!/*

2. Nazalizmi sekondar — Pos nazalizimit primar të shkaktuar nga mbyllja e rrokjeve me bashkëtingëlloret hundore: *m*, *n*, *nj*, të cilat u gjenden prapa zanoreve përkatëse, duke i ngjyrosur këto zanore me një timbër hundësimi, ndëshim edhe fjalë në të cilat është bërë nazalizimi i zanoreve nën ndikimin e analogjisë. Ky lloj nazalizimi quhet sekondar, sepse nuk është kushtëzuar me prani të zanoreve nazale, siç ka ndodhur me zanoret nazale primare. Kjo është njëra nga arsyet që na jep të drejtë ta emërojmë kështu, ndërsa arsyeja tjetër është se zanoret nazale sekondare që paraqiten në fjalët e caktuara, duke ndjekur parimin e analogjisë, gjeografikisht nuk i gjejmë të shtrira në të gjitha të folmet gege, për të cilën nazalizmi është dukuri e përbashkët fonetike, madje zanoret nazale sekondare mund të paraqiten nga njëherë vetëm në të folurit e përditshëm të individëve, edhe atëherë kur këta individë nuk kanë të meta fiziologjike të organeve me ndihmën e të cilave realizohet artikulimi i tingujve. Pra, në fjalët ku zanoret janë nazalizuar nga fenomeni i analogjisë, duke ndjekur zhvillimin evolutiv gjatë historisë së shkrimit, nuk kemi ndeshur praninë e bashkëtingëlloreve hundore *m*, *n*, *nj*, por në disa raste *m*-ja e *n*-ja janë shtuar si elemente të analogjisë, apo zanorja përkatëse është nazalizuar, duke na dhënë fizionominë dhe bindjen sekondare se ky hundësim është kryer në praninë e *m*-së e *n*-së, ku rol vendimtar ka lozur analogjia, si për shembull në fjalën *thmî-ja /për fëmijë-a*, nga lat. *familia/* Këtu *f*-ja është shkëmbyer me *th* ashtu si është shkëmbyer *th*-ja me *f*-në në fjalët: *uthull-ufëll*, *thellë-fell*, etj.; *kusî-ja*, *flî-ja/* te Gazulli e ndëshim *fërlî-ja* — pite me petë gruni, e mbëlmyeme dhe dhjam e ambëltue me mjaltë, Fj. ri fq. 128/, zanorja *i* te Gazulli nuk është e nazalizuar në fjalën *fërlî-ja*; ndërsa fjalët: *thnî-ja /vezë morri/*, *kacî-ja*, i përshkon nazaliteti, e fjala *frûth-i* është nazalizuar në analogji me fjalët *skûth /skunth ûthi/ unth-i/*, ndërsa *gûha/për gjuha/* në analogji me *gû-ni* për *gjû-ni*, dikur *gluni*; *hîth-i*, shumësi *hîtha*; në fshatin Pozharan ndëshim një toponim, emër arash *Rapû-ja*, nga një herë dëgjohet edhe *Rapû-ni*, që ka prejardhjen nga një bimë, kërcyelli i së cilës ka zemrën fyshtë, të zbrazët e quhet *rapuhë-a* ose *rapufë-a*. Në këtë

fjalë nazalizimi i *u*-së është bërë nën ndikimin e *n*-së, duke u përdorur shpesh përballë trajtës *Rapu-ja* edhe trajta *Rapû-ni*, e *n*-ja është ndajshtuar, duke ndjekur parimin e analogjisë, sepse historikisht nuk ka qenë kurrë prezente në këtë fjalë; *vâth-i* shm. *vâht* /stoli femrash/, *mî-ni* /nga latinishtja mus-muris/.

3. Zanoret e denazalizuara. — Derisa te zanoret nazale primare nazalizimi i zanoreve kushtëzohet nga organet fiziologjike në mënyrë objektive gjatë shqiptimit të vokaleve të ballafaquara drejtpërdrejt me bashkëtingëlloret hundore *m*, *n* apo *nj* dhe nga ndikimi subjektiv i shqipfolësit, duke u ndikuar nga shembujt analogjikë, janë nazalizuar edhe zanoret që nuk kanë pasur arsye fiziologjike objektive. Ndërkaq te denazalizimi i zanoreve ka ndodhur e kundërta edhe pse në shumë fjalë kushtet objektive janë të volitshme për nazalizimin e vokaleve sepse zanoret përkatëse gjenden apo janë gjendur përballë bashkëtingëlloreve hundore *m*, *n*, *nj*, e në vend që këto zanore të nazalizoheshin ato denazalizohen.

Mendoj se edhe këtu rol vendimtar ka luajtur analogjia ashtu sikur te nazalizimi sekondar, që është një lloj imitimi i nazalizimit primar, ndërsa këtu zanoret nazale primare janë denazalizuar nga ndikimi i zanoreve orale që janë gjendur për afërsisht në një familje fjalësh apo pjesë të ngjashme të ligjëratës. Shembuj të këtillë në këtë të folme nuk janë aq të shpeshtë, por megjithatë nuk mungojnë, duke paraqitur një dukuri fonetike përjashtuese. Sa për ilustrim lidhur me këtë që thamë deri më tani po sjellim disa shembuj të veçuar nga e folmja e përditshme: *buk'e grÿt* /*Po ham buk t'gryt*/. Këtu fjala *të grytë*, *grytë* e heq origjinën nga fjala *grun-i*, *buk e grÿnjt* /khs. me toponimin *Livadhet e grÿjes*, që gjendet në fshatin Komogllavë/. Këtu *u*-ja nën ndikimin e apofonisë si *lum-lym*, ka kaluar në *y*/khs. te Budi *grynjëra*, *lymna*, etj.⁹ Pra, *bÿk e grÿnt*, *bÿk e grÿnjt* *buk e grÿt* — *buk' e grÿt*. Këtu në fjalën *grytë* *n*-ja ka rënë ashtu sikurse ka rënë *r*-ëja në grupin *nt* te fjalët: *mêt*, *dhêt*, *qêt*, *çobât*, në Llap, Drenicë e në Shalë të Bajgorës.¹⁰ Nga fjala *turî-ni* ka dalë fjala *turëçk-a*, ku *e*-ja është denazalizuar ashtu sikurse *y*-ja te fjala *grytë*, sepse nuk gjenden më pranë konsonantit *n*. Nga folja *ai flen*, ndeshim trajtat *me flÿjt*, por edhe *me fjÿt* /aoristi: *fjÿta*, *fjete*, *fjÿt*/ gjithashtu *e*-ja është denazalizuar. Po kështu fjalët: *me ndrÿdh* dhe *me shtrÿdh*, lidhen me fjalën *me ndrÿ*, *e ndrÿni*, duke marrë sufiksin *-dh* dhe prefiksin *sh-*/Khs. *katër*, *shkatërr-ue*, *ngatrrue*.¹¹ Te fjalët *âj*, *çâj*; *m'u ka âj syni* apo *m'u ka çâj*; e shumë rrallë dëgjohet trajta me *â* nazale *m'u ka âj syni*, që është përfutur nga trajta e hershme *anjem* > *âjem* > *ajem* ashtu si te emri *grenjëzi* > *grëjzi* > *grejzi*; *xhÿ-ni*: *shtine thmÿn n'xhÿ*; *a i ke dhân thmÿs xhÿ* / fj. urtë: *pshtyj përpyt po t'bje n'sÿ*, *pshtyj teposht po t'bje n'xhÿ*/. Te fjala *xhÿ*, *i*-ja është denazalizuar, madje shpesh këtë fjalë e ndeshim edhe në

⁹ E. Çabej, *Për historinë e konsonantizmit të gjuhës shqipe*, Busaht nr. 1, 1958, 32

¹⁰ Latif Mulaku, *Govor albanaca Bajgorske Šalje*, Priština, 1968, 106

¹¹ E. Çabej, *Stund. Fil.* nr. 4/1964, 98

trajtë *xhi-vi*, ndërsa në të folmen e Grykës së Madhe të Dibrës¹² këtë fjalë e ndeshim të nazalizuar *gjî-ni*. Nga folja *me shtî* dëgjojmë foljen *po shtihet > shtihavç*; *zōj-a* (nga zonjë-a), në *Zarë*, *Zōja jōn*, *ftōj-t /ftōnj/*, *thōj-t /thōnjt/*, *dējē/* shkrirja e borës, vendi ku shkrin bora, vend i cekët në ujë, cekë,¹³ duke krahasuar me toponimin *Deja* të fshatit Cernicë, vërehet kryerja e denazalizimi të *e-së*.

Në këtë të folme ndeshim në ndonjë trajtë të rotacizuar, që ka shtegtuar nga të folmet që kanë për tipar rotacizmin, apo mund të jetë ndonjë relik i epokës së rotacizmit që ka përfshirë edhe ndonjë trevë të gegërishtes.

Kështu nga fjala *gjini*, kemi *gjiri*, me kuptim thellinë nëpër lumenj. Në fshatin Pozharan ndeshim në toponimin *Xhiri Daskallit* /do të thotë Gjini i Daskallit/.

Ndeshim edhe fjalën *lipetër-a* që është një lloj bari e që del nëpër livadhe me të cilin fshataret /amviset/ bëjnë lakëror. Mendoj se është trajtë e rotacizuar e fjalës *lëpetën-a*, ku *n*-ja është ngjitur më vonë, dhe duke iu ngjitur mbaresës së shumësit trupit të fjalës është formuar dhe *lëpjetër* „lëpjetë” në të folët e Lunxherisë, të cilën e sjell Menella Totoni.¹⁴ Shih edhe fjalën *egjër*, *egjra* përballë trajtës së parotacizuar *egjna*, që sjell M. Çeliku nga E folmja kalimtare e Shpatit.¹⁵

Gegërisht *krene* nga njëjësi *krye* që dha në toskërishte *krerë*, sipas Pedersenit jep të mendosh se edhe në gegërishte ka ekzistuar rotacizmi *n/r* apo Jokli që përmend *úr* përballë *û*, kur *r* gjendet edhe në trajtën gege ashtu si te fjala *kurpën*, tosk. *kulpërë*. Kjo të thotë se ka ekzistuar në gegërishte faza *n/r*, duke gjetur forma gege të cilat janë asimiluar *l/r* *kulpër* dhe *kulpen/r*¹⁶ në Moravën e Epërme këtë fjalë e ndeshim me sufiksin-*aj* *kërpnāj-a*, por edhe *kërkn-āj* në analogji me fjalët: *grunāj*, *dushkāj*, *firāj*, *bungāj*, etj. Mendohet se edhe trajta me *prarū* me *pranue dilli* është trajtë e rotacizuar e fjalës *perëndim=perenim=prenim* (me prenu) Sandfeldi dhe Majeri e lidhin me fjalën *perëndi-perëndoj*, *e > a*: *me pranue*, *me praru*. Ndërkaq folja *me pranue në ar* ka kuptim *me përarue*, *erxhan i prarūm* (argjend i veshur në ar), këtu nuk kemi të bëjmë me rotacizëm. Sikur kishte vënë në pah Eqrem Çabej „rotacizmi nuk është një dukuri vetëm e toskërishtes, por merr pjesë në të edhe gegërishtja në disa rasa”.¹⁷

¹² B. B e c i, *E folmja e Grykës së Madhe të Dibrës*, Stud. fil. nr. 3, 1972, 89

¹³ E. Ç a b e j, *Problemi i vendit të formimit të gjuhës shqipe*, Jehona, nr. 7, 1972, 69

¹⁴ E. Ç a b e j, *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1967, 170, në përçasje me fjalët: *drap*, *dhelpe*, *mangë*, *vorf*, *varf*, prej *drapën*, *dhelpën*, *mangën*, *vorfën*, *varfër*, etj.

¹⁵ M. Ç e l i k u, *E folmja kalimtare e Shpatit* Dialektologjia shqiptare I, Tiranë 1971, 212

¹⁶ A. B a l o t a, *La nasalisation e le rothacisme dans les langu ue: roumaine e albanaise*, Bucarest, 1926, 161.

¹⁷ E. Ç a b e j, *Hyrje në Historinë e gjuhës shqipe*, Prishtinë 1970, 31

T E K S T

DY ME HISE, NJO PA HISE

Ish kōn shku njōni me knū per hoxhallak//N'mot niher kisht pās ardh ka ni nāt n'shpi//Nihere pa u mūsh motmoti shkōn ni nāt n'shpi ni shoç i tina (i hoxhes) te gruja e hoxhes//—I thot grus mos e káll llamen hiç/se po ja prishmi xhumin nanes e babes//Çohet para sabahit/pa i dhân iz grūs hiç/edhe ik//Gruja u bâ marak ç i çysh iki burri pa kallxū hiç//N'dyten nāt i erdh burri i vet pi açehit/tu bâ lláf/gruja e veti burrin:—Shka u bâ, ç i pervjet ke ardh ka ni nāt/ e sivjet ka dy nēt/ku shkove ti ç i ike para sabahit/pa u mār vesh me bāb'e nān?//Burri e mūr vesh ç i koka kon çeter kush/po s'e bāni me zā//Kur rān me fjēt/aj s'ra me grū hiç/e shkrujti n'tefer ditën edhe shkōj//Mas nān mūjve i shkōj haberi ç i e ki ni xhāl//Aj e vertetoj ç i aj xhāl nuk āsht i veti, po i huji//Masi e kryjti shkollen/erdh te shpija/u plāk/i erdh koha per me dēk/i thirri kojshijen e ju kallxoj/ç i kur t'dahen xhēmt e mi ta kēn me dije se dŷ jan me hise/e njō pa hise//Kur banen m'u da u dasht me shku n'sūd//Kadija s'mujti hiç at nāt m'i drejtū/ e ju tha hajdeni t'nesrit//Shkōj te shpija kadija/e ish bâ marak ç i sun e çillojke ket pūn//Çika e kadijes tha: — hājt se une kam me ardh m'i sudit ata tre vllaznīt//Kur t'vin t'nesrit tre vllaznija/çika del te dera/e i përxhexh: — pritni pak se jena tuj ba niçah vlla e moter//Ata dy shka ishin me hise than: — Runa zot!/paska keç e ma keç//Aj pa hise tha: — Kurxhō s'āsht kjo pūn/motra e ka dāsht vllavin/vllavi motrēn//Çika e kadijes e mur vesh e i tha: — Ti koke pa hise//edhe e çiten harīç/pa hise se nana e vet e kish bâ me çeter būr/e krejt malli ju ra ktyne dy vllaznive//Kshtu e krenoj ket pun çika e kadijes//Kur shkūn te shpija i kallxūn nanes s'vet//Ajo tani ju kallxoj çysh u kōn puna/e çysh ka bâ vaki//

Tregoi: *Zahir Ademi*, bujk 50 vjeçar
nga fshati Vërban

Përfundim. — E foljmja e Moravës së Epërme është një e folme geqe. Ajo i takon grupit të madh të të folmeve geqe verilindore. Ndërsa në të folmet shqipe të Kosovës zë një vend në pjesën juglindore të krahinës. Në këtë grup të folmesh juglindore të Kosovës bëjnë pjesë të folmet e Luginës së Moravës jugore me malsitë e saja. Dallimet në mes këtyre të folmeve nuk janë aq të mëdha, këto më tepër kanë pika afruese se sa pika larguese, ndaj mund të kualifikohen si një grup i veçantë të folmesh me tipare të përbashkëta.

Veçoritë më karakteristike të së folmes së Moravës së Epërme në fushën e fonetikës janë:

1. Në dritën e theksimit të fjalëve, ruhet gjithnjë theksi dinamik, ndërsa ndeshim në shpërnguljen e theksit te fjalët e huazuara turke

oksitone, që kjo e folme i kthen në fjalë paraoksitone, për shembull: *shílete, sáde, káfe, váde, xháde, híle, híse*, etj., që në turqishte (edhe në toskërishte) shqiptohen: *shilté, sadé, kafé, vadé, xhadé, hilé, hisé*.

2. Shpërngulje të theksit kanë pësuar edhe një grup fjalësh autoktone shqipe si: *véri, njéri, nxhéti, úri, áher, çíri, kállí, njérthi*, etj., që në gjuhën letrare i ndeshim me theks në zanoren fundore: *verí, njerí, gjetíu (gjetkë), uríth, ahúr, qirí, kallí, mjeríth*.

Edhe në këtë të folme si në të folme të tjera të gegërishtes ruhet nazaliteti, por në një shkallë të mesme, duke mos arritur intesitetin e zanoreve hundore të të folmeve të gegërisë veriperëndimore. Në këtë të folme marrë në diakroni ndeshim tri farë zanoresh nazale: 1. zanoret nazale primare, 2. zanoret nazale sekondare të kushtëzuara në bazë të analogjisë dhe 3. zanoret e denazalizuara nga dobësimi i intesitetit, duke pasur edhe raste përjashtuese të rotacizmit.

3. Nazalizmi i përshkon të gjitha zanoret, përpos *ë-së*, ndërsa *o-ja* gjithashtu nazalizohet më rrallë se zanoret e tjera.

Me këto tipare që u vunë në spikamë del se e folmja e Moravës së Epërme bënë pjesë në grupin e madh të të folmeve gege verilindore, nga njëra anë, ndërsa konvergjon me të folmet e gegërisë së mesme në sistemin konsonantik, nga ana tjetër.

Mehmet Halimi

NASALISATION DU PARLER DE LA MORAVA E EPËRME

R é s u m é

Le parler de la Morava e Epërme est un parler guègue. Il appartient au grand groupe des parlers guègue du nord-est, tandis qu'aux parlers albanais du Kosovë il occupe une place dans la partie du sud-est de la province. Dans le groupe des parlers du sud-est du Kosovë font partie les parlers de la vallée de la Morava du sud avec ses pays montagneux. Entre ces parlers il n'y a pas de grandes différences, c'est pourquoi on peut les qualifier comme un groupe particulier des parlers avec des traits communs.

Les particularités caractéristiques du parler de la Morava e Epërme au domaine de la phonétique sont:

1. On garde toujours l'accent dynamique à la lumière de l'accentuation des mots, tandis que chez les mots d'emprunt turc oxitones on trouve un transfert de l'accent. Ce parler transforme les mots en paraoxytones. Par exemple: *shílte, sáde, káfe, váde, xháde, híle, híse*, etc., qui se prononcent en ture /mémé en toské/: *shilté, sadé, kalé, vadé, xhadé, hilé, hisé* etc.

2. Un groupe de mots autoktones albanais a aussi subi le transfert de l'accent: *véri, njéri, nxéti, úri, áher, çíri, kállí, njérthi*, etc. En langue littéraire nous les trouvons avec l'accent à la dernière voyelle: *verí, njerí, gjetíu /gjetkë/, uríth, ahúr, qirí, kallí, mjeríth*.

3. Cette contrée conserve parfaitement les monceaux *ae, oe*: *lae, pae, thae, dhae, rae* /II e pers. du passé simple/ et *droe, voe, veneroe*.

4. Dans ce parler les diphtongues ont presque atteint la phase de la monophthongaison, *ue > ū*: *ftū, prrū, krū, me punū, me livrū, me pushū* etc. *ye = ŷ*: *me lŷ, me shlŷ, me nerzŷ, me nersŷ, me ngashnjŷ, mais: krye*.

Dans ce parler, comme dans les autres parlers du guègue on garde la nasalisation mais jusqu'à un degré moyen, en atteignant pas l'intensité des voyelles nasales des parlers guègue du nord-ouest.

Prendre en diacronie, dans ce parler on trouve trois phases des voyelles nasales: 1. voyelles nasales primaires, 2. voyelles nasales secondaires conditionnées par analogie etc, 3. voyelles denasalisées de relachement de l'intensité, ayant aussi des cas exclusifs du rotacisme.

5. La nasalisation traverse toutes les voyelles, sauf *ě*, tandis que le *o* se nasalise plus rarement que les autres voyelles.

Avec ces traits qu'on a mis en évidence, le parler de la Morava e Epërme fait partie du grand groupe des parlers guègue du nord-est, d'une part, mais il converge avec les parlers du guègue intermédiaire dans le système consonantique d'autre part.

